

## MINISTRIA E ENERJISË DHE INDUSTRIË

Procedura e koncesionit/partneritetin publik privat

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës Dhënie me koncesion te hidrocentralit “Bushtrica 1”

Forma e kontratës B.O.T (Ndërtim – Operim – Transferim)

Burimi i financimit Shoqëri tregtare private / Kapital privat

Vlera e parashikuar e projektit: 506,147,190 Leke (pa TVSH)

Kohëzgjatja e kontratës : 35 vjet

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 17 date 2.5.2017

Njoftojmë se, kane qene pjesëmarrës ne procedure këta ofertues me ofertën përkatëse te ofruara:

1. Shoqëria “2T” sh.p.k. – Skualifikohet nuk ka plotësuar dhe dorëzuar ne mënyrë te rregullt Shtojcen nr. 1 “Formulari i ofertës”, ne kundërshtim me përcaktimin e germës “ç”, te shtojcës 9 te Dokumentave te Koncesionit.

2. Shoqëria “Doko” sh.p.k.

- Fuqia e instaluar e percaktuar me prurjen llogaritese 4,220 kW

Prodhimi i energjise elektrike 19,401,517 kWh

- Vlera e “Fee koncesionare” 2% (388,030 kWh)
- Koha e zbatimit te punimeve 12 muaj
- Kosto per njesi e makinerive dhe

Pajisjeve per kW fuqi te instaluar 49,000 leke/kW

- Vlera e investimit (pa TVSH) 506,147,190 Leke

\*\*\*

Ministria e Energjisë dhe Industrisë lajmëron Z. Fatbardh Doko, Përfaqësues ligjor i shoqërisë “Doko” sh.p.k., me adrese: Bradashesh, pranë Kombinatit Siderurgjik, Elbasan, se oferta e paraqitur më datë 6 Qershor 2017, për marrjen me koncesion te hidrocentralit “Bushtrica 2”, është pranuar.

Afati i negocimit te Kontratës tuaj do te jete brenda 60 ditëve nga marrja e njoftimit te fituesit. Shoqëria “Doko” sh.p.k. kërkohet t’i paraqesë Ministrisë se Energjisë dhe Industrisë dokumentet e mëposhtme:

Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve te Përgjithshme dhe te Veçanta te Kontratës Koncesionare\Partneritetin publik Privat, të nënshkruar.

Sigurimin e Kontratës sipas formës se kërkuar ne Dokumentat Standarte te Procedurës Konkurruese, ne vlerën e 10% te Investimit (pa TVSH). Sigurimi duhet te paraqitet jo me vone se ne momentin e nënshkrimit te Kontratës nga te dy palët.

Ofertën origjinale e shtypur/printuar ose e shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi me të drejtë nënshkrimi (i autorizuar me prokure) duhet te nënshkruajnë Ofertën duke nënshkruar origjinalin e ofertës; dhe firmosur në secilën faqe të origjinalit të dokumentave që shoqërojnë ofertën ekonomike. Oferta nuk duhet të ketë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim te rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtë nënshkrimi të ofertës. Oferta origjinale duhet të jetë identike me ofertën e ngarkuar në faqen e internetit të APP. Ne rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet te njoftoni me shkrim.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 14.6.2017

Ankesa: Shoqëria “2T” sh.p.k. ka bere ankimim pranë Komisionit te Prokurimit Publik (KPP), i cili ne përfundim te hetimit administrativ ka vendosur vijimin e procedurës koncesionare.